



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 185, datë 31.10.2016

PËR

PAGESAT E PRAKTIKAVE FOND KOMPENSIMI

Në bazë dhe për zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti me vendimin nr. 35, datë 24.03.2016 “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016”, ka miratuar Fondin e Kompensimit si dhe ka urdhëruar BSHS-në të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve duke patur parasysh periudhën më të hershme të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, të cilat duhet të fillojnë nga viti 2002 e në vijim.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar raportimit periodik të BSHS-së, për periudhën janar–30 shtator 2016, depozituar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 6345, prot, datë 11.10.2016, informon se pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit të kryera gjatë kësaj periudhë janë në vlerën 262,215,358 lekë, ose rreth 75% të vlerës së detyrimit të këtij Fondi, e llogaritur për periudhën deri më 30.09.2016.

Autoriteti bazuar në nenet 2 dhe 19 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe në funksion të mbikëqyrjes së BSHS-së, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me qëllim shlyerjen e detyrimeve që i përkasin Fondit të Kompensimit për ngjarjet e sigurimit më të hershme 2002-2006 ka kryer verifikim në vend pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit në datat 25-26 tetor 2016.

Nga verifikimi rezultoi se:

Detyrimet në total për dëmet e Fondit të Kompensimit për ngjarjet e sigurimit 2002-2006, për të cilat nuk është lëshuar ende autorizimi nga BSHS-ja për pagesë, rezultojnë në vlerën **55,508,223 lekë**.

Praktikat për këto ngjarje paraqiten si më poshtë:

1. Praktika të miratuara të papaguara gjithsej 71 në vlerën totale **4,062,525 lekë**:

2. Praktika te miratuara të cilat kanë marrë formë të prerë dhe për të cilat është lëshuar urdhër ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, gjithsej 11 praktika në vlerën totale **51,445,698** lekë.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se gjatë këtij viti, vetëm shoqëritë e sigurimit “Sigal Uniq Group Austria” sh.a., “Sigma Interbalkan V.I.G” sh.a. dhe “Eurosig” sh.a., kanë tërhequr dhe paguar praktika me ngjarje sigurimi të hershme.

Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes së BSHS-së, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me qëllim shlyerjen e gjithë detyrimeve që i përkasin ngjarjeve të sigurimit 2002-2006, si dhe në zbatim të vendimit të Bordit nr. 35, datë 24.03.2016 “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016”,

V E N D O S I:

1. Të urdhërohet Këshilli Administrativ i Byrosë Shqiptare të Sigurimit të procedojë brenda datës 10 nëntor 2016, me ndarjen e 11 praktikave për të cilat është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit nga Zyrat Përmbarimore.
2. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të dërgojë menjëherë autorizimet:
 - 2.1 Për ndjekjen e procedurës së pagesës pranë shoqërive të sigurimit të autorizuar për trajtimin e 71 praktikave administrative të miratuara por të papaguara;
 - 2.2 Për ndjekjen e procedurës së pagesës pranë shoqërive të sigurimit sipas ndarjes së përcaktuar nga Këshilli Administrativ i BSHS-së, për 11 praktikat për të cilat është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit nga Zyrat Përmbarimore.
3. Shoqëritë e sigurimit të autorizuar nga BSHS, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të përfundojnë procesin e pagesave brenda datës 30 nëntor 2016, si dhe të vijojnë me përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në vendimin nr. 35, datë 24.03.2016, “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016”.
4. Byroja Shqiptare e Sigurimit të raportojë mbi zbatimin e këtij vendimi brenda datës 14 nëntor 2016 si dhe cdo datë 10, të muajit pasardhës, sipas Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”, e ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmerisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI